



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 20 Datë 13.06.07
PËR

MIRATIMIN E KUOTËS SË BASHKISË PËR ADMINISTRIMIN E
MBETJEVE URBANE PËR RAJONIN E KORÇËS

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës për "Miratimin e kuotës së Bashkisë për administrimin e mbetjeve urbane për rajonin e Korçës", bazuar në në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", ligjin nr. 7638 dt. 19.11.1992 « Për shoqëritë tregtare », Udhëzimin nr 353 dt. 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K. Bashkisë nr 68 dt. 09.11.2006 "Mbi miratimin e aktit të themelimit të statutit të shoqërisë "Administrimi i mbetjeve urbane rajoni Korçë Sh.A. me titull dallues "AMURK" Sh.A.", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë kontributin e Bashkisë Korçë, në vlerën 700 000 lekë , për regjistrimin e shoqërisë « AMURK » Sh.A. sipas ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 « Për shoqëritë tregtare », në Gjykatën e Tiranës.

2. Ky fond do të përballohet brenda fondit të shpenzimeve operative të planifikuar për vitin 2007, të detajuar si poshtë :

EMËRTIMI	Fondi i planifikuar	Pakësohet	Shtohet	Fondi i mbetur
Telefon + postë	2.000	- 300		1.700
Udhëtim dieta	1.700	- 200		1.500
Njoftime në gazeta+ abonime	1.800	- 200		1.600
Kuote per administrimin e mbetjeve urbane	0		700	700

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës ne Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE
Raimonda NASE